

TRASHËGIMIA NATYRORE DHE FESTAT E LIDHURA ME TË

Këneta e Zezë

Pavarësisht përpjekjeve për ta tharë në kohën e socializmit, Këneta e Zezë nuk u tha. Burimet e saj të pashtershme e mbajnë ende të tillë sot, bashkë me një ekosistem unik me florë dhe faunë të pasur që meriton të hulumtohet nga biologët.

Prej se kur u hoq dorë prej idesë për ta tharë, uji i kënetës nisi të shfrytëzohej për mbushjen e Liqenit të Kurjanit. Ai dëgohej me pompa në këtë liqen-rezervuar e prej aty në tokat bujqësore për vaditje.

Në ditët e sotme, bashkia e Roskovecit synon që ta shndërrojë kënetën në një destinacion argëtues dhe turistik.

Kodra e Kurjanit

Nga kodra më e lartë e Kurjanit ku ndodhet edhe kisha e Shën Nikollës, syri të kap gjithë rrafshinën e Myzeqesë, Shpiragun dhe kodrat e Mallakastrës. Është një vendndodhje ku ia vlen të shpenzosh kohë për të njohur krejt zonën, për të shijuar ngjyrat e natyrës dhe diellin si dhe për të bërë foto të paharrueshme. Jo më kot është pikërisht ky vendi që është zgjedhur nga Bashkia për të zhvilluar festën e Ullirit, e cila është një traditë e bukur që mbledh çdo vit me qindra adhurues të ullirit dhe natyrës në përgjithësi.

Liqeni i Kurjanit dhe festa e 1 Majit

Liqeni i Kurjanit aktualisht është vendi që mbledh roskoveçarët në piknikun e festës së 1 Majit. Ndërkohë në pjesën tjetër të vitit ai është një vendndodhje natyrore pak e vizituar. Kjo hapësirë e madhe dhe e hijshme ujore bashkë me kodrat e butave që e rrethojnë ka potencial për t'u zhvilluar nga ana turistike.

Fshati Luar dhe Pylli i Luarit

Fshati Luar, me relief kodrinor dhe natyrë piktoreske, është përfshirë në projektin “100 fshatrat turistike shqiptare” me ç’rast ai ka hyrë në një hartë interesante të promovimit të agroturizmit. Ulliri është pema që e karakterizon peizazhin e këtij fshati por më tej edhe të krejt bashkisë së Roskovecit. Ndërkohë Pylli i Luarit, i mbushur me pisha të buta dhe me sipërfaqe prej 3 hektarësh, është vend i përshtatshëm për qëndrim dhe ecje në natyrë.

Ullishtat dhe Festa e Ullirit

Ulliri i kultivuar në këtë zonë të Shqipërisë qysh në lashtësi, sikurse e dëshmojnë gjetjet e amforave të vajit në vendbanimet fqinje të Apolonisë, Margëlliçit (Patosit), Antipatreas (Beratit), Dimalit, apo Bylisit, është sot pjesë deri edhe e emblemës së bashkisë së Roskovecit. Sipas statistikave këtu kultivohen rreth 450 000 rrënjë ullinj, të cilët përveç zonës kodrinore që e ka traditë brez pas brezi, mbillen me shumicë edhe në zonën e ulët fushore. Kjo kulturë përdoret gjerësisht në fushën e kulinarisë si ulli kokër për tavolinë, si dhe për të prodhuar vaj, që shfrytëzohet për gatime të ndryshme dhe përgatitjen e sallatave. Pikërisht ky vaj është edhe baza për festën e Ullirit e cila që prej vitit 2016 zhvillohet në kodrën e Kurjanit, në oborrin e kishës së Shën Nikollës. Festa shërben për promovimin e vajit të ri të prodhuar nga fabrikat vendase. Përveç aktiviteteve shoqëruese si koncerte dhe panair me produkte bujqësore dhe blegtorale, në të zakonisht ndahet një çmim për vajin më cilësor të vitit. Kjo festë konsiderohet si vlerë e shtuar që shkon në dobi të qytetarëve të Roskovecit.